

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC - Divizioni Civil**, gjyqtari **Jonuz Bugari**, kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve porot: **Aliriza Sokoli** dhe **Mustafë Cena**, antarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Qmega**, në çështjen juridike të paditësit N. K. nga fshati R., Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar N. G. Avokat nga Gjakova, Rr. “S. S.”,nr..., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës S. K. nga fshati R., Komuna e Rahovecit, për shkak të besimit, ruajtjes dhe edukimit të fëmijëve, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor jo publik, zbatimit të provave, pas këshillimit dhe votimit, më **28.02.2019** morri këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit **N. K.**, në mënyrën si vijon:

**FËMIJËT E. K.** i lindur më ... në Prizren, nga i ati **N. K.** dhe nga e ëma **S. K.**, dhe **R. K.** e lindur më ... në Prizren, nga i ati **N. K.** dhe nga e ëma **S. K.**, **I BESOHEN** në përkujdesje, ruajtje dhe edukim, babës të fëmijëve, këtu paditësit N. K..

**OBLIGOHET** paditësi që të paditurës nënës të fëmijëve S. K., t’ia mundësoj mbajtjen e kontakteve me fëmijët e tyre **E. K.** dhe **R. K.** edhe më tej sikurse që kanë kontaktuar deri më tani sipas vullnetit të tyre, po që se eventualisht fëmijët shkojnë në Zvicër tek i ati i tyre, kontaktet të zhvillohen në bazë të mundësive dhe rrethanave, kur fëmijët vijnë për pushime verore, dimërore si dhe gjatë festave shtetërore dhe ato fetare.

**Shpenzimet procedurale i bartë paditësi.**

## **A r s y e t i m**

Paditësi N. K., nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, në këtë gjykatë, ka parashtruar padi kundër të paditurës S. K., për shkak të besimit të fëmijëve E. K. dhe R. K., ku ndër të tjera ka cekur se pas themelimit të jetës së përbashkët jashtëmartesore kanë lindur 2 fëmijë. Në fillim edhe pse ndërgjyqësit nuk kishin lidhur kurorën, kanë pasur një harmoni në mes veti që manifestohej me dashuri dhe respekt të ndërsjelltë. Pas lindjes së fëmiut të dytë jashtëmartesor vajzës R. K. me datë 22.09.2010, në mes të ndërgjyqësve si bashkëshort kanë filluar të manifestohen mosmarrëveshje të shpeshta dhe serioze që kishin të bënin me perceptime e ndryshme të tyre lidhur me jetën e përbashkët martesore.

Lidhur me këtë çështje juridike, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 28.02.2019 në të cilën seancë kanë prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Avokati N. G. dhe e paditura S. K. personalisht.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se prej muajit Janar të vitit 2011 paditësi së bashku me anëtarët e familjes së tij të ngushtë janë përkujdesur për mirëqenien dhe edukimin e fëmijëve të mitur E. dhe R. K. të miturit kanë afërsi të madhe me të atin e tyre dhe janë të lidhur emocionalisht me të, meqenëse paditësi gjendet në Zvicër me leje qëndrimi të përhershëm, është i punësuar atje realizon të ardhurat të mira pra gëzon kushtet materiale të mira, ashtu që të miturve të tij ia siguron një të ardhme të sigurt. Në cilësinë e provës gjyqtarit të çështjes i prezantoj një faturë mujore që paditësi realizon të ardhurat nga marrëdhënia e punës, nga të cekurat më lartë i propozoj gjykatës që pas administrimit të provave dhe vlerësimit të provave të aprovojë padinë dhe kërkesën e saj si të bazuar.

E paditura ka deklaruar se i vërtetoi thëniet e cekura në padi si dhe thëniet e përfaqësuesit të paditësit të cekura gjatë seancës, se nuk e konteston kërkesëpadinë e paditësit meqenëse ata prej vitit 2011 jetojnë ndaras, paditësi jeton dhe punon në Zvicër ndërsa ajo jeton te prindërit e saj në fshatin R., kurse fëmijët po ashtu jetojnë në fshatin R., tek familja e paditësit, të cilët janë duke vijuar shkollën në fshatin R., fëmiju i madh është në klasën e 7 ndërsa fëmiju i dytë në klasën e 3, kontaktet është duke i vazhduar sa herë që ajo ka nevojë si dhe sa herë e shprehin vullnetin fëmijët e saj. Në mënyrë që fëmijët kur e shprehin dëshirën i merr edhe në shtëpinë e saj në fshatin e saj po ashtu edhe gjatë festave shtetërore dhe fetare edhe pse gjer më tani nuk ka pas pengesa për zhvillimin e kontakteve me fëmijët. I propozoj gjykatës që edhe tej të i mundësoj kontaktet kur ata e shprehin dëshirën e tyre të vijnë në shtëpinë gjyshit të tyre gjegjësisht babait të saj, eventualisht po që se ata shkojnë në Zvicër tek i ati i tyre kontaktet të zhvillohen në bazë të mundësive dhe rrethanave, kur fëmijët vijnë për pushimet verore, dimërore, festave shtetërore dhe ato fetare.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor pas dëgjimit të palëve, ka bërë edhe administrimin e provave si në vijim: ka bërë shikimin në ekstratin nga Regjistri Qëndror i Gjendjes Civile, Nr. Ser. E ... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë-R., më datë 12.06.2018, ka bërë shikimin në ekstratin nga Regjistri Qëndror i Gjendjes Civile, Nr. Ser. E ... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë – R., më datë 12.06.2018, ka bërë shikimin në deklaratën e bashkësisë familjare Nr. Ser. F ... e lëshuar më datë 17.05.2018, në Prizren, ka bërë shikimin në parashtresën e QPS-së, në Rahovec, nr.02-.../2018, e datës 14.11.2018. është dhe ka bërë shikimin në listën e pagave që i realizon paditësi N. K..

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe bashkërisht, e duke u bazuar në dispozitën e nenin 8 të LPK-së, në bazë të bindje së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar dhe e njëjta është aprovuar**.

Me shikimin në e ekstratin nga Regjistri Qëndror i Gjendjes Civile, Nr. Ser. E ... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë - R., më datë 12.06.2018, nga e cila vërtetohet se E. K. ka lindur më ... nga i ati N. K. dhe S. K..

Me shikimin në ekstratin nga Regjistri Qëndror i Gjendjes Civile, Nr. Ser. E ... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë – R., më datë 12.06.2018, nga e cila vërtetohet se R. K., ka lindur më ... nga i ati N. K. dhe S. K..

Me shikimin në deklaratën e bashkësisë familjare Nr. Ser. F ... e lëshuar më datë 17.05.2018, në Prizren, nga e cila deklaratë vërtetohet se fëmijët jetojnë me prindërit e tyre N. K..

Me shikimin në parashtresën e QPS-së, në Rahovec, nr.02-.../2018, e datës 14.11.2018, është konstatuar se QPS-ja, në bazë të vlerësimit të rrethanave në rastin konkret, ka dhënë mendimin përfundimtar, që duke marrë për bazë deklarimeve të palëve, mendojnë se është në interes që fëmijët e mitur të i besohen të atit të tyre, N. K., në ruajtje, përkujdesje, zhvillim dhe edukimin e tyre, pasi që të miturit emocionalisht janë të lidhur edhe me të atin e tyre.

Me shikimin në listën e pagave që i realizon paditësi vërtetohet se N. K. realizon të ardhura mujore në shumë prej 5,125.95 Franga Zvicrane.

Bazuar në provat e lartcekura si dhe nga dëgjimi i palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj të njëjtën e ka aprovuar, duke e marrë parasysht mendimin e QPS-së në Rahovec, si dhe deklarin e të paditurës.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të lartcekurat, e duke u bazuar në nenet 139.1, 144, 145, të Ligjit për Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**C.nr.368/2018, datë 28.02.2019.**

**B. Profesional**  
**Armond Qmega**

**Kryetari i trupi gjykues**  
**Jonuz Bugari**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë–Divizioni Civil.